

V E N D I M
Nr. 641, datë 22.11.2001

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 299, DATË 12.5.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR REGJISTRIMIN PËR SHITJE TË SIPËRFAQEVE TË TROJEVE TË
OBJEKTEVE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 299, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen që i bashkëlidhet vendimit pas numrit rendor 10 të shtohen numrat rendor, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat dhe rregullat, që do të zbatohen nga administratorët e shoqërive huamarrëse me bashkinë apo komunën, janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të vendimit nr. 299, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Grupi Mbikëqyrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe administratorët e shoqërive huamarrëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE PËR REGJISTRIM NË PRONËSI DHE SHOQËRIVE
HUAMARRËSE DHE VLERA E TRUALLIT PËR PAGESË NË BUXHETIN E BASHKISË APO
TË KOMUNËS**

Nr.	Objektet	Shoqëria në administrim	Sipërfaqja e tokës në m2	Çmimi i truallit në m2	Vlera e truallit për lekë
11.	Objekti serra, Vlorë	"Kamberi"	30 000	160	4 800 000
12.	Magazinë ambalazhi në ish-ndërmarrjen ushqimore, Vlorë	"Kamberi"	3 250	160	520 000
13.	Ish-ndërmarrja e bonifikimit, Vlorë	"Silva"	12 500	160	2 000 000
14.	Ish-reparti i traktorëve me zinxhirë	"Vefa Holding"	2 995	160	479 200
15.	Ish-reparti i restaurimit të traktorëve N.M. bujqësore	"Vefa Holding"	663	160	106 080